

Nr. Prot. 117/26

Data 03/06/2025



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Mitrovicës
Opština Mitrovica – Municipality of Mitrovica



NPL - "Qendra Multifunkionale" SH.A.

e-mail: qendraomnisport@gmail.com

Ndërmarrja Publike Lokale "QENDRA MULTIFUNKSIONALE" SH.A., shpallë:

**FTESË PËR OFERTË PËR DHËNIEN ME QERA TË HAPËSIRAVE FUNKSIONALE
DHE AFARISTE**

Ftoheni që të Ofertoni për marrje në shfrytëzim me Qera të Hapësirave Afariste, Sallave-(Zyre), të cilat janë pronë e NPL "QENDRA MULTIFUNKSIONALE" SH.A.

Hapësirat e evidentuara me poshtë u jepen me Qera personave juridik.

Hapësirat të cilat jepen me Qera:

Nr.	Hapësira	Destinimi	Sipërfaqja	Çmimi fillestar për m ²
1.	C3-314	Sallë për Ligjerata	90.00 m2	4.00 €
2.	C3-307	Sallë për Ligjerata	90.00 m2	4.00 €
3.	C1-206 C1-205 C1-207	Sallë e Fitnesit Zyre-Aneks Zyre-Aneks	183.00 m2 16.00 m2 16.00 m2	4.00 €

Kushtet e Përgjithshme

1. Periudha e Qeradhënies për Sallat e ligjëratave C3-317 dhe C3-307 është 1 (një) vitë me mundësi vazhdimi, preferohen për zyre apo veprimtari të ndryshme që përshtaten.

Periudha e Qeradhënies për Sallën e Fitnesit me anekset C1-206, C1-205, C1-207, është 3 (tri) deri në 10 (dhjetë) vite, me mundësi vazhdimi, preferohet për fitness apo veprimtari të ndryshme.

2. Qeramarrësi me anë të Nënshkrimit të Kontratës me Qeradhënësin, është i obliguar që të bëjë parapagimin e një shume monetare në vlerë të një Qeraje Mujore në llogari të Qeradhënësit.

Ofertuesi duhet t'i dorëzoj këto dokumente:

1. Kopjen e Certifikatës së Regjistrimit të Biznesit dhe numrit fiseal, (kopje)
2. Kopjen e një dokumenti identifikues të pronarit ose të përfaqësuesit të biznesit, (kopje)
3. Çmimin e ofertuar për m²
4. Vërtetimin nga ATK-ja, që të dëshmohet se biznesi është aktiv,

Ofertat nuk do të merren parasysh nëse:

1. Ofertuesi i cili ka pasur lokal me Qera në NPL "Qendra Multifunktionale" SH.A. dhe nuk i është përmbajtur Kontrata e Qerës ose ka obligime ndaj Ndërmarrjes,
2. Nëse oferta nuk i përmban të gjitha dokumentet e kërkuara,
3. Nëse Oferta arrin pas datës së skadimit të afatit të dorëzimit të ofertave të përcaktuara në Shpallje.

Personat Juridik të cilët duan t'i vizitojnë Hapësirat – Sallat (Zyrat) e lartcekura, mund t'a bëjnë, nga data: 03.06.2025, deri me datën 10.06.2025 nga ora 10.00 deri në ora 15.00.

Ofertat duhet të dorëzohen në zarf të mbyllur me datën: 10.06.2025 nga ora 10.00 deri në orën 12.00, në zyrën e arhivës së Qeradhënësit NPL "QENDRA MULTIFUNKSIONALE" SH.A.

Në pjesën e jashtme të Zarfit duhet të specifikohen:

1. Emri i Ofertuesit,
2. Nr i Hapësirës – Sallave (Zyrave) dhe
3. Adresat Kontaktuese, si: web-faqeja, e-mail, nr. i telefonit.

Ofertat do të hapen nga ana e Komisionit të formuar nga NPL "Qendra Multifunktionale" SH.A. me datë: 10.06.2025, nga ora:12:30, në prezencën e ofertuesve, në zyret e Administratës/Drejtorisë së NPL "Qendra Multifunktionale" SH.A. në Mitrovicë.

